

VENDIM
Nr. 154, datë 13.6.2022

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “ALBESP TRADING & CONSULTING” SHPK

(Ndryshuar me vendimin nr. 196, datë 3.8.2022)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 5, nenit 7 dhe nenit 9, pikat 4 dhe 5, dhe nenit 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 910 prot., datë 10.6.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënie e autorizimit ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë ‘AlbEsp Trading & Consulting’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., është licencuar në Veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 241, datë 2.12.2021, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 2.12.2021.

- Me shkresën nr. 16 prot., datë 9.2.2022, protokolluar në ERE me nr. 257 prot., datë 11.2.2022, shoqëria ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e kësaj shoqërie.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 95, datë 9.5.2022, ka vendosur: brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. të depozitojë në ERE dokumentacion plotësues, në lidhje me përshkrimin e kandidatit të propozuar për të kontrolluar interesat e shoqërisë dhe kontributit financiar të tij në ushtrimin e aktivitetit të licencuar.

- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimarrje, me shkresën nr. 257/5 prot., datë 24.5.2022, dhe brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 95/2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 257/6 prot., datë 9.6.2022. Sa më sipër, duke iu referuar edhe deklaratës së shoqërisë, se ajo konsideron zëvendësimin e aksionarit si një vlerë e shtuar për të çuar përpara biznesin e saj, me qëllim mbarëvajtjen e shoqërisë në vijim, vlerësohet se dokumenti i përcjellë nga shoqëria është i plotësuar tërësisht.

- Nga analiza përfundimtare që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. rezulton se ajo ka plotësuar tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, si vijon:

- Paraqitja e kërkesës – neni 5, pika 2, 4 dhe 5.

- Përmbajta e kërkesës dhe dokumentacioni i nevojshëm për dhënie e autorizimit nga ERE – neni 7, pika 1, germet “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, pika 2, germet “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “e”, “f”.

- Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa u përket pagesave të rregullimit.

- Shoqëria duhet të njoftojë ERE-n për bërjen efektive të transferimit të kuotave.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera për këtë transferim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k.

2. *Shfuqizuar.*

3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera për këtë transferim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti